

PLANI I VEPRIMIT

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PARANDALIMI DHE VETËDIJËSIMI

QËLLIMI:

Deri në vitin 2020, të zvogëlohen qëndrimet paragjyquese dhe sjelljet që mbështesin dhunën në familje, nëpërmjet informimit, edukimit, arsimit e vetëdijësit të vazhdueshëm të profesionistëve, komuniteteve e mbarë shoqërisë.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE:

- 1.1 Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesionistëve që ofrojnë shërbimet bazë (si: punonjës të policisë, prokurorë, mësues, edukatorë, mjekë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë, psikologë, punonjës socialë, mbrojtës të viktimave, etj) për parandalimin e dhunës në familje
- 1.2. Inkurajimi i viktimave për lajmërimin e rasteve të dhunës në familje dhe rritja e besimit të tyre tek institucionet përkatëse.
- 1.3. Rritja e vetëdijësit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës në familje

REZULTATET E PRITSHME:

- 1.1.a. Profesionistët e shërbimeve bazë (të tillë si: punonjës të policisë, prokurorisë, mësues, edukatorë, mjekë e profesionistë të tjerë shëndetësorë, psikologë, punëtorë socialë, mbrojtës të viktimave, etj), të aftësuar të identifikojnë dhe trajtojnë profesionalisht e pa paragjykime rastet e dhunës në familje.
- 1.2.a. Më shumë viktimë të dhunës në familje dhe anëtarë të shoqërisë të inkurajuar të besojnë tek institucionet përkatëse, dhe si rezultat më shumë raste të dhunës në familje të raportuara/lajmuara.
- 1.3.a. Një përqindje më e madhe e shoqërisë e vetëdijësuar për format e ndryshme të sjelljes së dhunshme, si dhe beson se dhuna në familje është e patolerueshme.

TREGUESIT NË NIVEL OBJEKTIVI

- 1.1.a.1. Rritja me 50% deri në vitin 2020, e numrit të profesionistëve të shërbimeve bazë¹ të trajnuar, të cilët vlerësohen² për trajtimin me profesionalizëm të rasteve të dhunës në familje. {*Njësia e matjes (Unit of measure)*: përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by)*: llojit të profesionistëve, komunave ku punojnë, numrit të trajnimeve të ofruara çdo vit, numrit të vlerësimeve të kryera dhe nëse është e mundur edhe vlerësimin që kanë marrë psh në shkallën nga 1 -5. *Mënyra e verifikimit (means of verification)*: të dhënat zyrtare, për gjithçka sa më sipër, dërguar në fund të vitit nga çdo institucion zbatues tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të Strategjisë, që do të përgatitet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF, bazuar në sistemin e M&E që do të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}

¹ Me profesionistë të shërbimeve bazë nënkuptohen të gjithë profesionistët që janë specifikuar si tek përshkrimi i rezulttit të pritshëm, ashtu edhe të detajuar më tej tek aktivitetet.

² Vlerësimi i profesionalizmit të tyre është fjala kyçe në matjen e këtij treguesi, pra objektivi do të quhet i arritur nëse nga totali i profesionistëve të trajnuar dhe certifikuar gjatë këtyre pesë viteve (2016 – 2020), të paktën 50 % e tyre deri në vitin 2020, do të vlerësohen se veprojnë me profesionalizëm në trajtimin e rasteve të DHF, sipas standardeve e në përputhje me njohuritë e ofruara në trajnime. Theksojmë se matja vetëm e numrit të profesionistëve të trajnuar nuk shërben për vlerësimin e arritjes së objektivit 1.1. Institucionet zbatuese duhet të marrin masa për të krijuar mekanizmin e duhur të vlerësimit të performancës vjetore të profesionistëve të tyre (nëse këto mekanizma ende nuk ekzistojnë) dhe rezultatet nga ky vlerësim do të shërbejnë për të matur arritjen e objektivit në fjalë. Nëse nuk do të arrijmë të japim të dhëna të sakta për % e profesionistëve të vlerësuar se trajtojnë me profesionalizëm rastet e DHF për vitin 2015, atëherë baseline për këtë tregues do ta konsiderojmë 0 dhe target 50% në fund të vitit 2020.

1.2.a.1. Rritja me të paktën 10%³ deri në vitin 2020, e numrit të lajmërimeve të rasteve të dhunës në familje, si rezultat i rritjes së besimit të individëve tek institucionet përgjegjëse që ofrojnë mbrojtje dhe trajtim të këtyre rasteve. {*Njësia e matjes (Unit of measure)*: përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by)*: gjinisë, moshës, aftësive të veçanta, arsimit, vendbanimit, statusit civil, vitit, institucioneve ku bëhet lajmërimi. *Mënyra e verifikimit (means of verification)*: të dhënat zyrtare për gjithçka sa më sipër, dërguar në fund të vitit nga çdo institucion zbatues tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF, ose raportet që do të përgatiten nga sistemi data bazë që pritet të ngritet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të Strategjisë që do të përgatitet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF bazuar në sistemin e M&E që do të ngritet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie, studimi mbarëkombëtar që do të bëhet sërish nga RrGGK në 2017 – nga ku është marrë edhe baseline për vitin 2014.}

1.3.a.1. Rritja me të paktën 20% deri në vitin 2020, e numrit të individëve të shoqërisë të vetëdijësuar për format e ndryshme të dhunës, si dhe që besojnë se dhuna në familje është e patolerueshme. {*Njësia e matjes (Unit of measure)*: përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by)*: gjinisë, moshës, aftësive të veçanta, arsimit, vendbanimit, statusit civil, vitit. *Mënyra e verifikimit (means of verification)*: studimi mbarëkombëtar që do të kryhet nga RrGGK në 2017 dhe ndoshta në 2019}

VEPRIME	GRUPET E SYNUARA	INSTITUCIONI ZBATUES	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	PERIUDHA KOHORE	TREGUESIT E MONITORIMIT	Financimi		
						Preventivi i kostos (€)	Burimet e mundshme	
							Financuar (€)	Kërkohej financim (€)
Objektivi 1.1 Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesionistëve që ofrojnë shërbimet bazë (si: punonjës të policisë, prokurorë, mësues, edukatorë, mjekë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë, psikologë, punonjës socialë, mbrojtës të viktimave, etj) për parandalimin e dhunës në familje.								
1.1.1. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i zyrtarëve të policisë fokusuar tek DHF, me tematika të qëlluara e module të aprovuara	Zyrtarët e policisë	AKSP dhe Policia e Kosovës	MPB Donatorët	2016-2020	Nr i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DHF; Kalendari i përvitshëm i trajnimeve i aprovuar	Gjithësej 78,973.52		Donatorët 78,973.52

³ Vlerësime dhe hulumtime të ndryshme të kryera, kanë treguar se numri i lajmërimeve për rastet e dhunës në familje rezultojnë: 29.8% për shqiptarët; 39.6% për serbët dhe 36.4% për grupe të tjera etnike, për vitin 2014. Nëse nuk do të zhvillohet një matje tjetër e numrit të rasteve që lajmërohen se kanë pësuar dhunë në familje, atëherë, këto përqindje mund të konsiderohen si baseline për të matur këtë tregues të sugjeruar në nivel objektiv.

					<p>Nr i zyrtarëve të policisë të certifikuar çdo vit</p> <p>Rregjistri me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, i përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo zyrtari</p>			
1.1.2. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe certifikimi i zyrtarëve të shëndetësisë, fokusuar tek DHF, me tematika të specifikuar e module të aprovuara	Zyrtarët e shëndetësisë	Ministria e Shëndetësisë	Qendrat e Mjekësisë Familjare, UNFPA	2016 - 2020	<p>Nr i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DHF;</p> <p>Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar</p> <p>Nr i zyrtarëve të shëndetësisë certifikuar çdo vit</p> <p>Rregjistri me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, i përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e</p>	Gjithësej 56,879.07		<p>Qeveria</p> <p>28,416.42 Donatorët</p> <p>28,462.65</p>

					certifikimeve të çdo zyrtari			
1.1.3. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i prokurorëve fokusuar tek DHF, me tematika të specifikuar e module të aprovuara.	Prokurorët	Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor	Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Nr i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DHF; Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar Nr i prokurorëve të çertifikuar çdo vit Rregjistri me të dhënat për prokurorët e trajnuar, i përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo prokurori	Gjithësej 11,991.61		Donatorët 11,991.61
1.1.4. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i gjyqtarëve fokusuar tek DHF, me tematika të	Gjyqtarët	Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor	Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Nr i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DHF;	Gjithësej 9,731.61		Donatorët 9,731.61

specifikuara e module të aprovuara					<p>Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar</p> <p>Nr i gjyqtarëve të çertifikuar çdo vit</p> <p>Rregjistri me të dhënat për gjyqtarët e trajnuar, i përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo gjyqtari</p>			
1.1.5. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i Mbrojtësve të Viktimave fokusuar tek DHF, me tematika të specifikuara e module të aprovuara	Mbrojtësit e Viktimave	Prokuroria e Shtetit	Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare	2016-2020	<p>Nr i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuara për DHF;</p> <p>Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar</p> <p>Nr i MV të çertifikuar çdo vit</p> <p>Regjistri me të dhënat për MV e trajnuar, i përditësuar në</p>	Gjithësej 16,701.67		Donatorët 16,701.67

					bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo MV			
1.1.6. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i punonjësve të QPS, QAP dhe ZP fokusuar tek DHF, me tematika të specifikuar e module të aprovuara	Puntorët socialë, Zyrtarët për BGJ dhe punonjësit e QPS, QAP, ZP	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	QPS QAP ZP Komunat, DKA	2016-2020	Nr i moduleve të aprovuara me tematika specifike për DHF; Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar Nr i punonjësve të çertifikuar çdo vit Regjistri me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, i përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo zyrtari	Gjithësej 38,681.86		Donatorët 38,681.86
1.1.7. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i stafit profesional (si: mësues, drejtorë, pedagogë, psikologë, këshilli	Psikologët Mësuesit	Divizioni për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve MASHT	ZAR Drejtoritë e Shkollave, OJQ	2016-2020	Nr i moduleve të aprovuara me tematika specifike për DHF;	Gjithësej 25,057.36		Donatorët 25,057.36

<p>drejtues i shkollës, pridër, zyrtarë nga drejtoritë komunale të arsimit) fokusuar tek DHF, me tematika të specifikuara e module të aprovuara</p>					<p>Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar</p> <p>Nr i të çertifikuarve në baza vjetore (4 grupe nga 80 pjesmarrës)</p> <p>Rregjistri me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, i përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo zyrtari</p>			
<p>1.1.8. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i gazetarëve dhe zyrtarëve të medias mbi mënyrën se si mund të përdoret media si mjet për parandalimin e DHF</p>	<p>Gazetarët Drejtuesit e medias</p>	<p>MAPL,AGK (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës)</p>	<p>MPMS</p>	<p>2016-2020</p>	<p>Nr i moduleve të aprovuara me tematika specifike për DHF;</p> <p>Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar</p> <p>Nr i të çertifikuarve çdo vit</p> <p>Regjistri me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, i</p>	<p>Gjithësej 9,494.46</p>		<p>Donatorët 9,494.46</p>

					përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo zyrtari			
1.1.9. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe çertifikimi i punonjësve të OJQ-ve fokusuar tek DHF, me tematika të specifikuar e module të aprovuara	Zyrtarët e OJQ-ve	MPMS Komuna ABGJ	OJQ Komuna Donatorët	2016-2020	Nr i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DHF; Kalendari vjetor i trajnimeve i aprovuar Nr i të çertifikuarve çdo vit Rregjistri me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, i përditësuar në bazë të trajnimeve të ofruara e certifikimeve të çdo zyrtari	Gjithësej 17,188.92		Donatorët 17,188.92
Objektivi specifik 1.2. Inkurajimi i viktimave për lajmërimin e rasteve të dhunës në familje dhe rritja e besimit të tyre tek institucionet përkatëse.								
1.2.1. Sistemimi i pedagogëve dhe psikologëve në	Shkollat	MASHT	MF, Komunat	2017 - 2020	Numri i pedagogëve dhe psikologëve të emëruar çdo vit;	Gjithësej 2,016,000.00	Qeveria 2,016,000.00	

shkolla (Për çdo vit janë planifikuar 80 pedagogë/e psikologë/e)					Numri i informatave të mbledhura prej tyre për rastet e DHF; Numri i rasteve të adresuara nga pedagogët dhe psikologët tek Mekanizmi Koordinues (në ato komuna ku ekziston MK) apo tek policia			
1.2.2. Plotësimi i Udhëzimit Administrativ për caktimin e pedagogëve dhe psikologëve (Pra, të ndryshohet U.A 26/ 2013 - zgjedhja e nëpunësve - që nr. i nxënësve për pedagogë dhe psikologë mos të kufizohet, por secila shkollë të ketë pedagogun dhe psikologun e saj)	Pedagogët Psikologët Shkollat	MASHT	Drejtoritë Arsimore MPMS	Tremujori i fundit 2016	Udhëzimi i ndryshuar	Gjithësej 280.00	Qeveria 280.00	

1.2.3. Informimi i publikut përmes medias për legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet përkatëse ku duhet të adresohen	Publiku në tërësi (fokus i veçantë gratë)	Asociacioni i Pavarur i Mediave	Media, Policia, MV, MK, Komuna, donatorët, organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Numri i emisioneve televizive apo radiofonike të organizuara; Nr i spoteve televizive të prodhuara dhe shfaqura (shpeshtësia e shfaqjes së tyre është gjithashtu e rëndësishme)	Gjithësej 87,038.90		Donatorët 87,038.90
1.2.4. Shpërndarja e informacioneve për legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet përkatëse ku duhet të adresohen	Publiku në tërësi (fokus i vecantë gratë)	MASHT Drejtoritë Komunale për Arsim, ZBGJ-të në Komuna	Ministrië e linjës Anëtarët e MK, Donatorët, organizatat ndërkombëtare	2016-2020	% e popullsisë e ndërgjegjësuar për legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet ku duhet të adresohen Llojshmëria e mjeteve të përdorura (fletëpalosje, broshurë, poster, etj); Nr i materialeve të prodhura dhe shpërndara çdo vit, detajuar sipas tematikës, komunave dhe	Gjithësej 61,700.00		Donatorët 61,700.00

					institucioneve që e kanë përgatitur e realizuar			
1.2.5. Zbatimi me përgjegjësi e profesionalizëm i PSV-ve	PK, QPS, MSH, MV, Strehimore	Secili institucion i cituar në PSV	Institucionet përkatëse dhe OJQ	2016-2020	<p>Nr i ankesave për moszbatim të PSV paraqitur tek ZKNDHF, detajuar sipas institucioneve që nuk kanë zbatuar PSV;</p> <p>Numri i masave të ndërmarra nga ZKNDHF në bashkëpunim me ministritë e linjës për institucionet kundrejt të cilave janë listuar ankesat;</p> <p>Numri i personave të certifikuar rregullisht në baza vjetore për aplikimin e PSV</p> <p>Nr i shkollave të pajisura me formularët e PSV dhe për matjen e DHF</p> <p>Nr i formularëve të shpërndara nga institucionet</p>	Gjithësej -		

					arsimore për parandalimin e DHF dhe zbatimin e PSV.			
Objektivi specifik 1.3. Rritja e vetëdijësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës në familje								
1.3.1. Rishikimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKK) të Arsimit Para Universitar (APU) dhe përfshirja në të e informacioneve të standardizuara për DHF, si dhe dhënia e informacioneve për DHF, grupeve punuese për hartim të kurrikulave lëndore - kategorizuar sipas të gjitha grupeve mbi të cilat mund të ushtrohet kjo dhunë (gra, fëmijë, të moshuar, PAK, LGBT, komunitetet jo-shumicë , etj), llojeve të dhunës si dhe ku mund të	Nxënësit, mësuesit	MASHT	ABGJ, OJQ-të MF	2016 - 2017	Numri i kurrikulave të rishikuara, detajuar sipas tematikave dhe viteve; Nr i programeve të përfshira, detajuar sipas llojeve të dhunës si dhe ku mund të bëhet lajmërimi për rastet e dhunës	Gjithësej 18,789.30	Qeveria 18,789.30	

bëhet lajmërimi për rastet e dhunës								
1.3.2. Studime nacionale periodike mbi fenomenin, përmasat, profilin e kryesëve të dhunës në familje/viktimave të dhunës në familje, etj	Publiku	Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF (ZKNDHF)	ABGJ Ministritë e linjës Institucionet lokale; OJQ-të; Donatorët, organizatat ndërkombëtare	2017 2020	Studimet e botuara	Gjithësej 26,690.00		Qeveria 13,345.00 Donatorët 13,345.00
1.3.3. Zhvillimi i buletineve statistikore vjetore mbi numrin e rasteve të raportuara dhe trajtuara në mënyrë multidisiplinare	Profesionistë të fushave të ndryshme	Zyra e Koordinatorit Nacional ABGJ Komuna	Ministritë e linjës Institucionet lokale, antarët e MKR OJQ, donatorët, organizatat ndërkombëtare	2017-2020	Nr i buletineve statistikore të botura çdo vit, në nivel qendror e vendor, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në internet	Gjithësej 47,932.22	Qeveria 47,932.22	
1.3.4. Organizmi i kampanjave nacionale vetëdijësuese çdo vit, me tematika të përcaktuara në përputhje me ditët/kampanjat ndërkombëtare të organizuara për të njëjtin qëllim, si dhe duke targetuar grupe të ndryshme të individëve që	Publiku në tërësi	Zyra për Qeverisje të Mirë /ZKM	Ministritë e linjës Institucionet lokale, antarët e MKR, komuna OJQ, donatorët, organizatat ndërkombëtare, ZMV	2016-2020	Nr i kampanjave të organizuara; Kalendarët e koordinuar të aktiviteteve; Llojet e aktiviteteve të zhvilluara, nr i pjesëmarrësve në to, detajuar sipas	Gjithësej 104,080.80		Qeveria 42,872.80 Donatorët 61,208.00

rezultojnë më të prekur nga dhuna në familje, si: gratë, fëmijët, të moshuarit, PAK, LGBT, komunitet/ RAE.					<p>grupeve që iu përkasin</p> <p>Numri i aktiviteteve vjetore të MASHT (nën temën “Dua jetë të lumtur në familjen time - fëmijët nuk duan dhunë në gjirin familjar)</p> <p>Numri i aktiviteteve mbajtur me nxënës e prindër në disa nga lëndët mësimore (gjuhë shqipe, edukatë qytetare, fushë të arteve etj)⁴</p>			
1.3.5. Involvimi i politikanëve në veprime vetëdijësuese me transmetimin e porosive të përcaktuara nga ZKNDHF për vetëdijësimin e popullatës kundër dhunës në familje	<p>Politikanët</p> <p>Gratë deputete</p> <p>Gratë asambleiste</p>	Kuvendi	ABGJ asamblatë komunale OJQ	2016-2020	Nr i aktiviteteve të organizuara, nr i politikanëve pjesëmarrës, detajuar sipas gjinisë, partisë politike, etj	Gjithësej 13,010.10		Qeveria 13,010.10

⁴ 1-2 në vit ,me 2-4 shkolla, 40-60 pjesëmarrës në grup

<p>1.3.6. Mbajtja e ligjëratave të vazhdueshme në baza vjetore nga gjyqtarët dhe prokurorët për vetëdijësimin e profesionistëve të rinj në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje (shembull: Ligjëratat me studentët e praktikantët që mbahen në baza vjetore nga Forumi i Grave Gjyqtare dhe Prokurore)</p>	<p>Studentët e universiteve të drejtësisë dhe shkencave sociale</p>	<p>Prokuroria e Shtetit, Gjykatat themelore</p>	<p>MD, Komunat, ABGJ, KKDFH</p>	<p>2016 - 2020</p>	<p>Nr i ligjëratave të mbajtura çdo vit, detajuar sipas tematikave dhe institucioneve që i kanë realizuar (gjykatë, prokurori), e komunave ku janë mbajtur; Nr i pjesëmarrësve i detajuar sipas gjinisë, moshës, fakultetit, komunes, etj.</p>	<p>Gjithësej 5,000.00</p>	<p>Qeveria 5,000.00</p>	
<p>1.3.7. Përfshirja e viktimave të riintegruara të dhunës në familje, si modele të fuqizimit, në aktivitete vetëdijësuese (me vullnetin dhe konsensusin e tyre të plotë)</p>	<p>Grupet e rrezikuara</p>	<p>Komunat, MD, ABGJ</p>	<p>MD, ABGJ, OJQ</p>	<p>2018-2020</p>	<p>Nr i aktiviteteve të zhvilluara me praninë e viktimave të riintegruara, nr i pjesëmarrësve, etj</p>	<p>Gjithësej 16,000.00</p>	<p>-</p>	<p>Donatorët 16,000.00</p>

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA DHE KOORDINIMI

QËLLIMI

Deri në vitin 2020, të sigurojmë mekanizma institucionale gjithëpërfshirës dhe efikasë për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje si dhe bashkëpunim ndërinstytucional të përgjegjshëm mes akterëve në nivel qendror e lokal për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre rasteve.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- 2.1. Avansimi i politikave gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.
- 2.2. Përmirësimi i funksionalizimit të mekanizmave koordinues institucionale ekzistues në nivel lokal si dhe ngritja e tyre në komunat ku mungojnë.
- 2.3. Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e viktimave përmes qartësisimit të roleve, detyrave dhe përgjegjësive të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuate.

Rezultatet e pritshme:

- 2.1.a. Më shumë politika gjithëpërfshirëse dhe standarde të avansuara të aplikuara me përgjegjësi për mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave të dhunës në familje.
- 2.2.a. Mekanizma koordinues institucionale funksionale dhe efikasë, të shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës.
- 2.3.a. Më shumë shërbime ndërinstytucionale dhe të koordinuara ndërmjet nivelit qendror e lokal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje të ngritura në mbarë Kosovën, të specializuara e diversifikuara sipas kërkesave e standardeve të parashikuara në legjisllacionin vendor e atë ndërkombëtar.

TREGUESIT NË NIVEL OBJEKTIVASH

- 2.1.a.1. Rritja në masën 50% deri në vitin 2020, e numrit të politikave dhe standardeve të përmirësuara të aplikuara⁵ për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. *{Njësia e matjes (Unit of measure):* përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by):* llojit të politikave apo standardeve të përmirësuara e të miratuara çdo vit, që zbatohen rregullisht nga institucionet, sipas komunave. *Mënyra e verifikimit (means of verification):* të dhënat zyrtare, për gjithçka si më sipër, dërguar në fund të vitit nga çdo institucion zbatues tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të Strategjisë që do të përgatitet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF, bazuar në sistemin e M&E që do të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}
- 2.2.a.1. Rritja me të paktën 50% nga viti 2017 deri në vitin 2020, e efektivitetit dhe efikasë⁶ së funksionimit të 13 Mekanizmave Koordinues ekzistues. *{Njësia e matjes (Unit of measure):* përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by):* komunave ku ekzistojnë MK. *Mënyra e verifikimit (means of verification):* të dhënat zyrtare, për gjithçka si më sipër, të nxjerra nga vlerësimi për funksionimin e MK që mund të realizohet gjatë viti 2016}

⁵ Nuk do të mjaftojë vetëm numërimi i politikave apo standardeve të ndryshuara e përmirësuara, por përmes sistemit të monitorimit e vlerësimit do të bëhet i mundur evidentimi i përqindjes së këtyre politikave të përmirësuara që zbatohen realisht, çdo vit.

⁶ Për të matur rritjen e efikasë duhet të bëhet një vlerësim i funksionimit të këtyre mekanizmave të ngritur (psh në fund të vitit 2016), që do të shërbejë edhe si baseline për vitin 2017 e në vijim.

2.2.a.2 Themelimi i tetë Mekanizmave Koordinues të rinj çdo vit⁷ duke filluar nga viti 2017, në komunat ku mungojnë. *{Njësia e matjes (Unit of measure):* numri. *Specifikuar sipas (disaggregated by):* komunave, institucioneve që mbështesin ngritjen e MK, vitit kur themelohen, numrit të institucioneve që marrin pjesë, etj. *Mënyra e verifikimit (means of verification):* të dhënat zyrtare, për gjithçka si më sipër, dërguar në fund të vitit nga çdo institucion zbatues tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të Strategjisë, që do të prodhohet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DHF, bazuar në sistemin e M&E që do të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}

2.3.a.1. Rritja me të paktën 3% duke filluar nga viti 2018, e shërbimeve ndërinstitucionale e të koordinuara për mbrojtjen e viktimave të DHF. Shërbimet duhet të jenë të diversifikuara⁸ e sipas standardeve⁹ të kërkuara në legjislacionin vendor e atë ndërkombëtar.

VEPRIMTARITË	GRUPET E SYNUARA	INSTITUCIONI ZBATUES	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	PERIUDHA KOHORE	TREGUESIT E MONITORIMIT	Financimi		
						Preventivi i kostos (€)	Burimet e mundshme	
							Financuar (€)	Kërkohej financim (€)
Objektivi specifik 2.1. Avansimi i politikave gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje								
2.1.1. Rishqyrtimi dhe rishikimi i politikave dhe programeve ekzistuese	Viktimat, kryesit	KNKDHF	ABGJ, ministrinë e linjës, organizatat ndërkombetare, OJQ-të,	2016-2020	Nr i programeve të rishqyrtuara dhe propozimeve të përgatitura; Nr i ndryshimeve të miratuara	Gjithësej 5,866.16	Qeveria 5,866.16	
2.1.2. Rishikimi i nevojave për plotësimin dhe ndryshimin e formularëve të PSV-ve	Viktimat	ABGJ	Ministrinë e linjës, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të	2017 - 2018	Nr i formave të reja të referimit të propozuara; Nr i formave të reja të referimit të aplikuar	Gjithësej 391.58	Qeveria 391.58	

⁷ Për të arritur përbushjen e objektivit që deri në fund të viti 2020 të jene themeluar MK institucionale edhe në komunat ku mungojnë, është përlogaritur që çdo vit, duke filluar nga viti 2017, të ngrihen 8 MK të rinj – sepse nga totali prej 38 komunash që ekzistojnë në Kosovë, 13 i kanë MK tashmë, ndaj dhe mbeten për t'u plotësuar edhe 25 komuna. Grupi punues gjithsesi ka për detyrë të saktësojë shifrat dhe targetin e vendosur në këtë rast.

⁸ Nënkupto që shërbimet duhet të jenë të qasshme e disponueshme për të gjithë individët që pësojnë dhunë në familje, duke përfshirë gratë, fëmijët, të moshuarit, PAK, LGBT, etj. Po kështu diversifikimi duhet të bëhet edhe në llojshmërinë e shërbimeve (këshilim, shërbim ligjor falas, strehim, etj sipas kërkesave që specifikohen edhe në Konventën e Stambollit)

⁹ Nënkupto: ofrimin e shërbimit në të gjitha gjuhët që fliten në vend, respektimin e standarteve sipas llojit të shërbimit, etj

2.1.3. Përmirësimi i standardeve të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje	Viktimat dhe viktimat e mundshme	MPMS	ABGJ, KKDHF OJQ, Organizatat ndërkombetare, MSH, shtëpitë e shëndetit-drejtoritë komunale të shëndetësisë	2018–2020	Nr i standardeve të reja të propozuara; Nr i standardeve të përmirësuara/miratuara	Gjithësej 156.63	Qeveria 156.63	
Objektivi specifik 2.2. Rritja e funksionalizimit të mekanizmave koordinues institucionalë ekzistues në nivel lokal si dhe ngritja e tyre në komunat mungojnë								
2.2.1. Rritja e përgjegjësisë të ZBGJ-ve për të përfshirë edhe detyrën si Koordinator Lokal i MK, si dhe kompensimi adekuat i tyre në përputhje me përgjegjësitë e shtuara	ZBGJ dhe MK	Komuna	MPMS, Donatorët	2016 - 2020	Përshkrimi i punës së ZBGJ përfshin përgjegjësinë e tyre si Koordinatorë të MK; Paga e harmonizuar në përputhje me përgjegjësitë.	Gjithësej 66,000.00	Qeveria 66,000.00	
2.2.2. Krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave për rastet e trajtuara në mënyrë të koordinuar nga ana e MK	Anëtarë e MK	Komuna KNDHF	Ministritë e linjës, Policia e Kosovës, antarët e MK, Gjykatat themelore, Prokuroritë themelore, Këshilli gjyqësor Donatorët,	2016-2020	Sistemi (Data baza) i ngritur; Raportet periodike të përpiluara e dorëzuara tek anarët e MK si dhe pranë KNDHF	Gjithësej 56,632.00	Qeveria 13,832.00	Qeveria 7,600.00 Donatorët 35,200.00

			organizatat ndërkombëtare					
2.2.3. Trajnimi i anëtarëve të MK për bashkëpunimin ndërinstitucional si dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave për rastet e trajtuara mënyrë të koordinuar nga ana e MK	Anëtarët e MK	IKAPI dhe mekanizmat e tjerë institucionalë që ofrojnë trajnime	Komuna, anëtarët e MK, donatorët	2016-2020	% e anwtarëve të MK të trajnuar për përdorimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave për rastet e trajtuara mënyrë të koordinuar Kapacitetet e përmirësuara, demonstruar nga përdorimi me efektivitet dhe eficensë i sistemit të të dhënave	Gjithësej 43,980.00		Donatorët 43,980.00
2.2.4 Shtirirja e Mekanizmave Koordinues komunalë në komunat që mungojnë	Viktimat dhe fëmijët e tyre	MAPL	Institucionet përgjegjëse anwtare të MK	2016 - 2020	Nr i MK të reja të themeluara; Nr i Memorandumeve të Mirëkuptimit të nënshkruara	Gjithësej 199,991.00	Qeveria 199,991.00	
2.2.5. Krijimi i një nënkategorie për financimin e Zyrës për Barazi Gjinore në nivel komunal dhe mbështetjen e funksionimit të MK	MK	Komunat	Institucionet përgjegjëse antare të MK	2017 - 2020	Nr i komunave që krijojnë një vjë buxhetore për mbështetjen e funksionimit të MK, çdo vit	Gjithësej -		

Objektivi specifik 2.3. Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe organizatave të shoqërisë civile, për mbrojtjen e viktimave, përmes qartësimi të roleve, detyrave dhe përgjegjësi të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuata.

2.3.1. Shtimi i shërbimeve të ofrimit të ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në familje	Viktimat, familja	MD	Gjykata , Oda e Avokatëve, OJQ	2016 – 2020	Nr i shërbimeve të reja të ndihmës ligjore falas të ngritura në vit (target mund të jetë edhe shtrirja në komuna)	Gjithësej 229,545.23	Qeveria 229,545.23	
2.3.2. Shtimi i numrit të Mbrojtësve të Viktimave serbisht-folës, (si dhe folës të gjuhëve të tjera sipas komuniteteve jo-shumicë që ekzistojnë në Kosovë) në zyrat ekzistuese, si dhe hapja e zyrave të Mbrojtësve të Viktimave (aty ku mungojnë psh në veri)	Viktimat dhe fëmijët e tyre	Prokuroria e Shtetit,-MV-te	KKDHF, Donatorët Mbrojtësit e viktimave	2016-2020	Nr i MV serbisht-folës (si dhe folës të gjuhëve të tjera sipas komuniteteve jo-shumicë që ekzistojnë në Kosovë) të shtuar në zyrat ekzistuese. Nr. i zyrave të reja të hapura (target shtrirja gjeografike)	Gjithësej 251,400.00	Qeveria 251,400.00	
2.3.3.Shtimi i numrit të stafit të shërbimit të linjës telefonike falas ekzistuese	Viktimat dhe viktimat e mundshme	Prokuroria e Shtetit	KKDHF, MD OJQ, org ndërkombëtare, Komunat, Donatorët	2016 - 2017	Numri i stafit serbisht-folës të shtuar në shërbimin ekzistues të linjës telefonike të ndihmës (si dhe folës të	Gjithësej 198,720.00	Qeveria 198,720.00	

edhe me punonjës serbisht-folës (si dhe folës të gjuhëve të tjera sipas komuniteteve jo-shumicë që ekzistojnë në Kosovë) si dhe shtrirja e këtij shërbimi në zonat ku mungon (p.sh në veri)					gjuhëve të tjera sipas komuniteteve jo-shumicë që ekzistojnë në Kosovë). Shërbimi i ngritur aty ku mungon			
2.3.4. Krijimi i partneritetit ndërkomunal (regjional) për identifikim, referim, strehim, rehabilitim dhe fuqizim të viktimave të DHF.	Viktimat dhe fëmijët e tyre,	Komunat, MPB, MPMS	QPS, strehimoret, policia regjionale OJQ, organizatat ndërkombëtare	2016 - 2020	Nr i marrëveshjeve regjionale të nënshkruara; % e buxheteve komunale të transferuara për këtë qëllim	Gjithësej -		
2.3.5. Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët dëshmitarë të dhunës në familje, me theks të veçantë fëmijët-djem mbi 12 vjeç	Fëmijët Djemtë mbi 12 vjeç	QPS	Komuna, OJQ	2016 - 2020	Nr i shërbimeve të ngritura për fëmijët dëshmitarë të dhunës në familje; Nr i qendrave që mundësojnë mbrojtjen dhe trajtimin e djemve mbi 12 vjeç	Gjithësej 97,915.10	Qeveria 97,915.10	

<p>2.3.6. Përshtatja e shërbimeve mbrojtëse në mënyrë që të jenë të qasshme edhe për grupet me nevoja të veçanta (të tillë si persona me AK, LGBT, komunitete jo-shumicë – ofrimi i shërbimit në gjuhën e tyre, etj), në përputhje dhe me standardet e përmirësuara e të miratuara bazuar në ato ndërkombëtare.</p>	<p>Viktima të DHF, sidomos ato me nevoja apo nga grupe të veçanta,</p>	<p>MPMS, KKDFH dhe akterët e tjerë</p>	<p>Komuna, OJQ</p>	<p>2017-2020</p>	<p>Nr i shërbimeve mbrojtëse të përshtatura edhe për trajtimin e grupeve me nevoja të veçanta</p>	<p>Gjithësej -</p>		
<p>2.3.7. Shtimi i burimeve dhe stafit të Zyrës së Koordinatorit Nacional kundër DHF, të cilët të kenë në përshkrimin e tyre të punës përgjegjësi specifike për mbështetjen e zbatimit dhe monitorimin e Strategjisë</p>	<p>ZKNDHF</p>	<p>MF</p>		<p>2017 - 2020</p>	<p>% e buxhetit e shtuar në ZKNDHF Nr i stafit i shtuar në ZKNDHF (të paktën 1 person i shtuar)</p>	<p>Gjithësej 32,256.00</p>	<p>Qeveria 32,256.00</p>	

Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje								
2.3.8. Ngritja e një sistemi të konsoliduar monitorimi dhe vlerësimi në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie	Institucionet përgjegjëse për zbatim	ZKNDHF, ABGJ	UN Women, Donatorë	2017	Sistemi i ngritur	Gjithësej 4,500.00		Donatorët 4,500.00
2.3.9 ¹⁰ . Krijimi i bazës së përbashkët të të dhënave të rasteve të trajtuara nga policia, prokuroria, gjyqësori, si dhe trajnimi i punonjësve për përdorimin e kësaj data baze	Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjkata, QPS, MV, strehimoret	Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Policia e Kosovës	Donatorët, MD, MPB	2017	Data baza e krijuar Numri i rasteve të raportuara për çdo vit Raportet e ndara sipas seksit, moshës së viktimave dhe kryesve, llojit të dhunës, dhe marrëdhënies mes viktimës dhe kryesit, si tregues në bazën e të dhënave	Gjithësej 81,638.16	Qeveria 27,488.16	Qeveria 16,800.00 Donatorët 37,350.00

¹⁰ Kujdes: ky system është në nivel qendror dhe është i ndryshëm nga sistemi që sugjerohet në aktivitetin 2.2.2, që ka të bëjë me shëmbim të rregullt të të dhënave ndërmjet të gjithë antarëve që bëhen njesë e Mekanizmit Koordinues përmes nënshkrimit të Memorandumit të Mirëpuktimit të hartuar për këtë qëllim.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: LEGJISLACIONI, HETIMI DHE PROCEDIMI

QËLLIMI 3:

Deri në vitin 2020, të përmirësohet infrastruktura ligjore dhe të ngritet efikasiteti i trajtimit të rasteve të DHF, me fokus në nevojat e viktimës së dhunës në familje si dhe realizohet ndëshkimi adekuat i kryesit.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- 3.1. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe akteve tjera për trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje.
- 3.2. Specializimi i hetuesve policorë, punëtorëve socialë, mbrojtësve të viktimave, prokurorëve dhe gjyqtarëve, për procedimin me urgjencë e kujdes të shtuar të rasteve të dhunës në familje
- 3.3. Qartësimi i roleve, detyrave dhe përgjegjësive të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuate për rastet e dhunës në familje

Rezultatet e pritshme:

- 3.1.a. Legjislacion i përmirësuar dhe i harmonizuar që ndjek penalisht dhe vendos përpara përgjegjësisë kryesit e çdo forme të dhunës në familje.
- 3.2.a. Profesionistë të specializuar që reagojnë me prioritet e kujdes të shtuar ndaj nevojave të viktimës së dhunës në familje
- 3.3.a. Institucione të përgjegjshme me role të qartësuara që zbatojnë me përpikmëri legjislacionin, nën frymën e tolerancës zero kundër dhunës në familje

TREGUESIT SIPAS OBJEKTIVAVE

- 3.1.a.1. Numri i ligjeve dhe akteve të tjera të amendamentuara dhe/ose të aprovuara, deri në fund të vitit 2020, për trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje. *{Njësia e matjes (Unit of measure):* Numri. *Specifikuar sipas (disaggregated by):* akteve ligjore apo neneve të ndryshuara. *Mënyra e verifikimit (means of verification):* të dhënat botuar në Gazetën Zyrtare}
- 3.1.b.1. Rritja me 10%¹¹ çdo vit, duke filluar nga viti 2018, e numrit të kryesve të dhunës në familje të ndëshkuar penalisht, sipas parashikimit të ri të kësaj vepre në Kodin Penal të Kosovës. *{Njësia e matjes (Unit of measure):* përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by):* numrit të kryesve të ndëshkuar, llojit të veprës së kryer, masës së dënimit të shqiptuar, vitit, etj. *Mënyra e verifikimit (means of verification):* të dhënat zyrtare, për gjithçka sa më sipër, raportuar nga MPB}
- 3.2.a.1. Numri total i hetuesve policorë, punëtorëve socialë, mbrojtësve të viktimave, prokurorëve dhe gjyqtarëve, të specializuar për procedimin me urgjencë e kujdes të shtuar të rasteve të dhunës në familje. *{Njësia e matjes (Unit of measure):* Numri. *Specifikuar sipas (disaggregated by):* numrit të zyrtarëve të specializuar, institucionit përkatës, nr të rasteve të trajtuara pas specializimit, etj. *Mënyra e verifikimit (means of verification):* të dhënat zyrtare, për gjithçka si më sipër, raportuar nga institucionet përkatëse tek ZKNDHF}
- 3.2.b.1 Rritja me 3% çdo vit e fondit të buxhetit të shtetit që shkon për investime në përmirësimin e infrastrukturës dhe profilizimin e profesionistëve¹². *{Njësia e matjes (Unit of measure):* përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by):* investimeve të kryera çdo vit për shumën të vecanta, apo për

¹¹ Duke qenë se propozimi i këtij ndryshimi ligjor ka qenë një nga pikat më të debatueshme gjatë hartimit të Strategjisë, sugjerojmë që antarët e Grupit Ndër-ministor, gjatë punorisë për kostimin e Planit të Veprimit të Strategjisë, ta vlerësojnë edhe një herë përqindjen e propozuar tek treguesit në nivel objektivash (për të gjithë treguesit në këtë nivel) për qëllimin strategjik 3. Viti 2018 është propozuar si viti për matjen e këtij treguesi, duke pasur parasysh që vetë ndryshimi ligjor do të kërkojë kohë, e ndoshta matja e tij gjatë vitit 2017 do të ishte e parakohshme, (psh nëse ky ndryshim në Kodin Penal të Kosovës nuk do ishte miratuar deri në këtë vit). Plus viti 2017 mund të shërbejë edhe si vit provë i zbatimit të këtij ndryshimi dhe të dhënat që do mblidhen në këtë vit, mund të përdoren si baseline për të matur treguesin e propozuar, nga viti 2018 e në vijim)

¹² Edhe kjo % e sugjeruar duhet të rivlerësohet edhe një herë në punëtorinë e kostimit, pasi gjatë punës për hartimin e Strategjisë, nuk u dha një informacion i saktë mbi % e buxhetit të shtetit që shkon për këtë qëllim.

trajtime të profesionistëve, vitit, etj. Mënyra e verifikimit (means of verification): të dhënat zyrtare nga buxheti i shtetit si edhe nga raportimet vjetore për përdorimin e këtij buxheti}

3.3.a.1. Numri i institucioneve me role, detyra e përgjegjësi të bashkërenduara, që punojnë nën frymën e tolerancës zero kundër dhunës në familje. {Njësia e matjes (Unit of measure): Numri. Specifikuar sipas (disaggregated by): politikave apo marrëveshjeve institucionale ose ndër-institucionale të përmirësuara. Mënyra e verifikimit (means of verification): të dhënat zyrtare dërguar nga institucionet përkatëse tek ZKNDHF}

3.3.b.1. Rritja me 10% çdo vit e numrit të urdhërave mbrojtës të zbatuar me efektivitet¹³. {Njësia e matjes (Unit of measure): përqindja. Specifikuar sipas (disaggregated by): urdhërave mbrojtës të lëshuar, numrit të UM të shkelur, etj Mënyra e verifikimit (means of verification): të dhënat zyrtare, nga policia e shtetit dhe MD}

AKTIVITETI	GRUPET E SYNUARA	INSTITUCIONI ZBATUES	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	PERIUDHA KOHORE	TREGUESIT E MONITORIMIT	Financimi		
						Preventivi i kostos (€)	Burimet e mundshme	
							Financuar (€)	Kërkohej financim (€)
Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe akteve tjera për trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje								
3.1.1 Rastet e DHF të trajtohen si shkelje të të drejtave të njeriut, me qëllim që të marrin trajtim me përparësi nga prokuroria dhe gjykata	Prokurorët, gjyqtarët	Këshilli Gjyqësor Këshilli Prokurorial	Mbrojtësit e viktimave, QPS, Institucionet gjyqësore, OJQ, org ndërkomb, PK	2016-2017	Nr i rasteve të DHF të trajtuara me prioritet nga gjykata dhe prokuroria	Gjithësej 14,472.00	Qeveria 14,472.00	
3.1.2. Caktimi i grupit punues të profesionistëve (përfshirë edhe OJQ-ve me përvojë në punën me DHF) për harmonizimin e bazës ligjore me	Ministria e Drejtësisë, Profesionistët në fushën e drejtësisë	Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Policia e Kosovës, MD (Grupi punues i	MPB, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Policia e Kosovës, MPB, Organizatrat ndërkombëtare,	2016 – 2017	Nr i rekomandimeve të përgatitura nga grupi punues Udhëzuesi i miratuar	Gjithësej 13,500.00	Qeveria 6,750.00	Donatorët 6,750.00

¹³ Edhe kjo % duhet të verifikohet sërish në puntorinë për kostimin, pasi nuk na është vënë në dispozicion një statistikë në lidhje me nr. e urdhërave mbrojtës që zbatohen me efektivitet çdo vit. Nëse nuk ekziston, atëherë duhet të matet gjatë këtij viti (2016) dhe të dhënat të shërbejnë si baseline për vitet në vijim. Një tjetër mënyrë e shprehjes së këtij treguesi mund të jetë edhe zvogëlimi me 10% çdo vit i numrit të shkeljeve të urdhërave mbrojtës – sërish nevojitet baseline dhe masa e përqindjes duhet të përcaktohet me Grupin Ndër-ministror gjatë puntorisë së kostimit

standardet ndërkombëtare dhe me studimet ekzistuese, si dhe për hartimin e udhëzuesit për politikat ndëshkimore, përfshirë dhe ashpërsimin e politikës ndëshkimore ndaj recidivistëve		profesionistëve) ABGJ	OJQ-të, Donatorët,					
3.1.3. Amandamenti i ligjeve – përplotësimi i legjislacionit me qëllim të specifikimit të dhunës në familje si vepër penale në Kodin Penal të Kosovës, në përputhje me përkufizimin e dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje	Ministria e Drejtësisë,	Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Policia e Kosovës	MPB, Organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, Donatorët,	2017	Kodi i ndryshuar DHF parashikuar si vepër penale, në KPK	Gjithësej 5,600.00	Qeveria 5,600.00	
3.1.4. Shmangia e fragmentarizimit të procedurave penale dhe civile	Prokurorët, gjyqtarët	Këshilli Gjyqësor Këshilli Prokurorial	Mbrojtësit e viktimave, QPS, Institucionet gjyqësore, OJQ,	2016 – 2018	Shqiptimi i UM në procedure civile automatikisht	Gjithësej 10,180.80	Qeveria 10,180.80	

gjatë trajtimit të rasteve nga prokuroria dhe gjykata			org ndërkomb, PK		bëhet pjese e dosjes së prokurorisë për ndjekjen penale; Nr i procedurave të unifikuara			
3.1.5 Aplikimi me efektivitet i deklaratës së dëmit (me synim të realizimit të dëmshpërblimit nga i pandehuri në procedurë penale)	Mbrojtësit e viktimave, Prokurorët, Gjkata	Institucionet gjyqësore, Këshilli Gjyqësor	Policia e Kosovës, OJQ-të	2016 - 2020	Aplikim i plotë i deklaratës së dëmit në procedurë; Gjyqtarët trajtojnë dëmshpërblimin në procedurë penale.	Gjithësej 28,565.63	Qeveria 28,565.63	
Objektivi specifik 3.2. Specializimi i hetuesve policorë, punëtorëve socialë, mbrojtësve të viktimave, prokurorëve dhe gjyqtarëve për procedimin me prioritet e kujdes të shtuar të rasteve të DHF								
3.2.1 Vlerësimi i veçantë i rrethanave dhe menaxhimi i rrezikut në të gjitha veprat penale me elementë të DHF, nga Policia e Kosovës dhe prokuroria	Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjkata, QPS, shtëpia e sigurtë, shërbimi sprovues, shëndeti mendor	Policia e Kosovës, prokuroria,	Mbrojtësit e viktimave, gjykata, SHS, QPS, QPS, org ndërkomb, EULEX, OSBE, Qeveria	2016 – 2020	Nr i rasteve të trajtuara	Gjithësej 392,148.94	Qeveria 392,148.94	
3.2.2. Sigurimi i infrastrukturës në polici, për trajtimin adekuat dhe sipas standardeve të rasteve të DHF	Policia e Kosovës	MPB	MD, MF, Donatorët	2017- 2020	Nr i dhomave të veçanta të intervistimit të themeluara;	Gjithësej 25,000.00	Qeveria 10,000.00	Qeveria 15,000.00

3.2.3. Sigurimi i zyrtarëve në polici që flasin gjuhën serbe (apo dhe gjuhë të tjera në varësi të komuniteteve jo-shumicë prezente në Kosovë), për trajtimin adekuat dhe sipas standardeve, të rasteve të DHF	Policia e Kosovës	MPB	MD, MF, Donatorët	2017- 2020	Nr i zyrtarëve të policisë që flasin serbisht, si edhe gjuhë të tjera në varësi të komuniteteve jo-shumicë prezente në Kosovë, i vënë në dispozicion për komunitetin	Gjithësej 171,393.77	Qeveria 171,393.77	
3.2.4. Sigurimi i infrastrukturës, në prokurori, për trajtimin adekuat dhe sipas standardeve, të rasteve të DHF	Prokuroria	Këshilli Prokurorial	MD, MF, Donatorët	2017- 2020	Nr i dhomave të veçanta të intervistimit të themeluara;	Gjithësej 35,000.00		Qeveria 10,000.00 Donatorët 25,000.00
3.2.5. Sigurimi i prokurorëve dhe mbrojtësve të viktimave që flasin gjuhën serbe, (apo dhe gjuhë të tjera në varësi të komuniteteve jo-shumicë prezente në Kosovë), për trajtimin adekuat dhe sipas standardeve, të rasteve të DHF	Prokuroria	Këshilli Prokurorial	MD, MF, Donatorët	2017- 2020	Nr i prokurorëve dhe MV që flasin serbisht (apo dhe gjuhë të tjera në varësi të komuniteteve jo-shumicë prezente në Kosovë), i vënë në dispozicion	Gjithësej 75,413.26	Qeveria 75,413.26	
3.2.6. Sigurimi i gjyqtarëve që flasin gjuhën serbe (apo dhe gjuhë të tjera në varësi të komuniteteve jo-	Gjyqësori	Këshilli Gjyqësor	MD, MF, Donatorët	2017- 2020	Nr i gjyqtarëve që flasin serbisht (apo dhe gjuhë të tjera në varësi të komuniteteve jo-	Gjithësej 75,413.26	Qeveria 75,413.26	

shumicë prezente në Kosovë), për trajtimin adekuat dhe sipas standardeve, të rasteve të DHF					shumicë prezente në Kosovë), i vënë në dispozicion			
3.2.7 Caktimi i prokurorëve, gjyqtarëve dhe policëve të specializuar të DHF	Prokuroria , Gjykata, Policia e Kosovës	Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Policia e Kosovës	MD, MPB, Organizatat ndërkombëtare	2016	Nr i prokurorëve, gjyqtarëve dhe policëve të specializuar për DHF. të caktuar në institucione	Gjithësej 443,909.86	Qeveria 443,909.86	
3.2.8. Trajnimi dhe çertifikimi prokurorëve, hetuesve, gjyqtarëve, mbrojtësve të viktimave, për t'u specializuar për rastet e DHF	Hetuesit policorë, prokurorët , gjyqtarët	Gjykata, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Policia e Kosovës	Organizatat ndërkombëtare, MD, MPB	2016 - 2020	Moduli i përgatitur dhe institucionalizuar Nr i trajnimeve të ofruara Nr i çertifikatave të lëshuara	Gjithësej 46,612.33		Donatorët 46,612.33
3.2.9. Trajnime të përbashkëta për bashkërendimin e rasteve të dhunës në familje	Polici, Prokurori, Gjykatë	Instituti Gjyqësor i Kosovës, KGJK,KPK, Policia e Kosovës	MPB, Organizatat ndërkombëtare, MPB, MD	2016 – 2018	Nr i trajnimeve të ofruara Nr i pjesëmarrësve i ndarë me shënime gjinore	Gjithësej 69,464.83		Donatorët 69,464.83
Objektivi specifik 3.3. Qartësimi i roleve, detyrave dhe përgjegjësi të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuate								
3.3.1. Rishikimi i detyrave,	Policia e Kosovës,	Këshilli Gjyqësor,	ABGJ, KNDHF Donatorët	2016 - 2017	Nr i përkrahjeve të detyrave të	Gjithësej 2,569.44	Qeveria 2,569.44	

përgjegjësi dhe bashkërendimi i procedurave të secilit institucion përgjegjës (polici, gjyqësor, mbrojtës të viktimave, prokurori) në mbrojtje të viktimave të DHF.	prokuroria, Gjykata, Shërbimi Sprovues	Këshilli Prokurorial, Policia e Kosovës, Mbrojtësit e viktimave			rishikuara dhe përfunduara sipas cdo institucioni Nr i përmirësimeve të aprovuara nga çdo institucion			
3.3.2. Zbatimi efektiv i urdhërave mbrojtës, monitorimi dhe ndëshkimi adekuat si dhe sensibilizimi mbi shkeljet e tyre, përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve të shërbimit sprovues për të zvogëluar shkallën e recidivizmit	Policia e Kosovës, gjykatë, prokurori, mbrojtësi i viktimave, njësi për DHF në Policinë e Kosovës, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokuroria I	Policia e Kosovës, Prokuroria, Gjykatat, Qendrat për Punë Sociale	Mbrojtësit e viktimave, QPS, Institucionet gjyqësore, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Oda e Avokatëve, ABGJ, Ndihma Juridike Falas, OJQ, organizatat ndërkombëtare, Shërbimi sprovues	2016 - 2020	Nr i urdhërave të lëshuar Numri i dënimeve të urdhërave të shkelur Nr i raporteve të lëshuara për dënimin e kryesit në rastet e recidivizmit Nr. i trajnimeve të stafit të shërbimit sprovues për të monitoruar rastet e recidivizmit	Gjithësej 1,937,868.33	Qeveria 1,928,201.93	Donatorët 9,666.40

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI

QËLLIMI :

Deri në vitin 2020, të mundësohet qasja në shërbime të reja dhe ekzistuese, efikase dhe të qëndrueshme, për rehabilitimin dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave dhe rehabilitimin e kryesve të dhunës në familje në tërë territorin e Kosovës.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- 4.1. Ngritja e shërbimeve për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje dhe rritja e efektivitetit të tyre, në nivel qendror e komunal.
- 4.2. Ndarja e fondeve për shërbimet riintegruese afatgjata për viktimat e dhunës në familje, në nivelin qeveritar
- 4.3. Përdorimi i politikave të integruara për përmirësimin e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje
- 4.4. Themelimi i institucioneve rehabilituese dhe këshillimoreve me programe të obligueshme për kryesit e dhunës në familje.

Rezultatet e pritshme:

- 4.1.a. Shërbime rehabilituese efikase të ofruara viktimave të dhunës në familje në tërë territorin e Kosovës
- 4.2 a. Programe riintegruese afatgjata të mbështetura vazhdimisht nga buxheti i shtetit dhe të aplikuar në nivel qendror e lokal
- 4.3.a. Komuna me kapacitete të përmirësuara, që aplikojnë politika të integruara për përmirësimin e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje
- 4.4.a. Programe të obligueshme dhe efektive për rehabilitimin e kryesve të dhunës në familje, të ofruara nga institucione të specializuara për këtë qëllim.

TREGUESIT NË BAZË TË OBJEKTIVAVE

- 4.1.a.1. Rritja me 2% çdo vit, duke filluar nga viti 2017, e numrit të shërbimeve të ngritura, që rehabilitojnë dhe riintegrojnë efektivisht¹⁴viktimat e dhunës në familje {*Njësia e matjes (Unit of measure)*: numri/përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by)*: llojit të shërbimeve të ngritura çdo vit, numrit të tyre, komunave, si dhe efikasiteti i funksionimit të tyre, i vlerësuar përmes metodave të caktuara, sipas komunave. *Mënyra e verifikimit (means of verification)*: të dhënat zyrtare, për gjithçka si më sipër, mbledhur përmes të dhënave zyrtare që raporton çdo fundviti komuna në ZKNDHF, ose raportet e monitorimit dhe vlerësimit që do hartohen çdo vit bazuar në sistemin e M&E që do ngritet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}
- 4.2.a.1. Rritja me 2% çdo vit, duke filluar nga viti 2017, e vijave buxhetore vjetore të ngritura nga institucionet qeveritare për plotësimin e nevojave për shërbimet rehabilituese dhe riintegruese¹⁵. {*Njësia e matjes (Unit of measure)*: përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by)*: institucioneve dhe planeve buxhetore vjetore, duke përcaktuar edhe llojin e shërbimeve që mbështesin. *Mënyra e verifikimit (means of verification)*: të dhënat zyrtare, të buxhetit të institucioneve qeveritare vjetore, si edhe të dhënat për raportin e shpenzimeve të këtyre linjave buxhetore}
- 4.3.a.1. Rritja me 2% çdo vit, duke filluar nga viti 2017, e numrit të viktimave që përfitojnë shërbime riintegruese. {*Njësia e matjes (Unit of measure)*: përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by)*: numrit të viktimave që përfitojnë çdo vit nga shërbimet sipas komunave, llojit të shërbimeve që kanë përfituar, kohëzgjatjes, etj. *Mënyra e verifikimit (means of verification)*: të dhënat zyrtare, për gjithçka si më sipër, mbledhur përmes të dhënave zyrtare që raporton çdo fundviti komuna në ZKNDHF, ose raportet e monitorimit dhe vlerësimit që do hartohen çdo vit bazuar në sistemin e M&E që do ngrihet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}

¹⁴ Pra ideja është që nuk do të përlogaritet vetëm numri i shërbimeve të reja rehabilituese dhe riintegruese për viktimat, që do të ngriten çdo vit duke filluar nga viti 2017, por do të matet me metoda specifike (të përcaktuara gjatë ngritjes së sistemit të monitorimit dhe vlerësimit) performanca e shërbimeve të ofruara dhe do të quhet objektiva e zbatuar nëse efikasiteti i këtyre shërbimeve do të rritet me 2% çdo vit.

¹⁵ Bazuar në vlerësimin e nevjave dhe buxhetimin gjinor vjetor të kryer nga institucionet përkatëse dhe të përfshirë në treguesit e buxhetit të performancës së tyre, apo në justifikimin e shpenzimeve.

4.4.a.1. Rritja me 5% çdo vit e numrit të kryesve të dhunës që rehabilitohen përmes programeve të obligueshme të ofruara nga institucione të specializuara. {*Njësia e matjes (Unit of measure)*: përqindja. *Specifikuar sipas (disaggregated by)*: llojit të shërbimeve të ngritura, numrit të kryesve që trajtohen në to, sipas komunave, si edhe efikasiteti i funksionimit të tyre, i vlerësuar përmes metodave të caktuara. *Mënyra e verifikimit (means of verification)*: të dhënat zyrtare, për gjithçka si më sipër, mbledhur përmes të dhënave zyrtare që raporton çdo fundviti komuna në ZKNDHF, ose raportet e monitorimit dhe vlerësimit që do hartohen çdo vit bazuar në sistemin e M&E që do ngrihet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}

AKTIVITETI	GRUPET E SYNUARA	INSTITUCIONI ZBATUES (Bartës/ Kryesor)	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	PERIUDHA KOHORE	TREGUESIT E MONITORIMIT	Financimi		
						Preventivi i kostos (€)	Burimet e mundshme	
							Financuar (€)	Kërkohej financim (€)
Objektivi specifik 4.1.Ngritja e shërbimeve për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje dhe rritja e efektivitetit të tyre, në nivel qendror e komunal.								
4.1.1 Ofrimi i këshillimit psiko-social profesional për viktimat e dhunës në familje në afat të shkurtër dhe të gjatë kohor, nga profesionistë të çertifikuar	Viktimat, kryesi, familja	MSH, MPMS	DSHM QPS, komisioni komunal, Komisioni për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, DSHMS, Strehimoret	2016 - 2020	Nr i programeve këshillimore të përgatitura për aplikim nga profesionistë të certifikuar Nr i profesionistëve të cerifikuar për të ofruar këto programe këshillimi Nr i viktimave të trajtuara në mënyrë profesionale	Gjithësej 14,265.67	Qeveria 14,265.67	

4.1.2. Trajtimi mjekësor dhe këshillues i viktimave të DHF në institucionet shëndetësore ekzistuese (qendra të shëndetit mendor, psikolog, psikiatër/psikiatri,etj)	Viktimat familja	MSH	Komuna, ZBGJ, QKUK-Neuro-Psikiatra dhe psikologë, Shëndeti primar, QMF, Instituti i Forenzikës	2016 – 2020	Nr i viktimave të trajtuara (i specifikuar sipas qendrave ku bëhet trajtimi, profesionistëve që ofrojnë trajtimin, etj)	Gjithësej 107,886.26	Qeveria 107,886.26	
4.1.3. Përfshirja e viktimave të DHF në programe arsimore ekzistuese për të rriturit	Viktimat e DHF	DKA MASHT	Komuna, ZBGJ, Drejtoritë Arsimore, Shkolla, OJQ-të	2016 – 2020	Nr i programeve arsimore të hartuara për këtë qëllim në bazë të ligjit për Arsim për të rritur, Nr. 04/L-143 Nr i viktimave të përfshira çdo vit në programe arsimore Nr i bursave të ndara për përfshirjen e viktimave në programet arsimore	Gjithësej 28,310.58	Qeveria 28,310.58	

4.1.4. Hapja e strehimoreve të reja duke adresuar nevojat e komuniteteve jo-shumicë	Viktimat, fëmijët	Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Graçanicës	QPS, OJQ, Donatorët, komuna të tjera që do përfitojnë nga ky shërbim, etj	2017 – 2020	Nr i strehimoreve të reja të ngritura, specifikuar sipas komunave Kapaciteti i këtyre strehimoreve (numri i personave që mund të mbështesin)	Gjithësej 410,457.82		Donatorët 410,457.82
4.1.5. Hapja e një strehimore për djemtë dhe burrat viktimë të dhunës në familje	Djemtë mbi 12 vjeç dhe burrat	Komunat, Ministrinë e linjës	QPS, OJQ, organizatat ndërkombëtare	2018	Strehimorja e ngritur Kapaciteti i kësaj strehimoreje (numri i personave që mund të strehohen)	Gjithësej 214,967.41		Donatorët 214,967.41
4.1.6. Trajnimi i personelit të strehimoreve ekzistuese me qëllim që të jenë të gatshme të ofrojnë shërbime cilësore, sipas kategorive të ndryshme të viktimave të DHF,	Personeli i strehimoreve	Zyra e Koordinatorit Nacional, Ministrinë e linjës	Komunat, Donatorët, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të	2016 – 2020	Vlerësimi i kapaciteteve të përmirësuara përmes analizës së formularëve para/pas trajnimit të organizuar	Gjithësej 11,466.40	Qeveria 11,466.40	

edhe për LGBT, komunitetin RAE dhe komunitete tjera jo-shumicë, etj.					Nr i viktimave të strehuara të specifikuara sipas katrakteristikave të ndryshme			
4.1.7. Sigurimi i strehimit afatgjatë për viktimat, nëpërmjet marrëveshjeve të mirëkuptimit në mes të Komunave, Strehimores, QPS dhe Komisionit për banim social përfshirë edhe strehimin rajonal me anë të marrëveshjeve ndërkomunale	Viktimat	Komunat	QPS, Strehimoret, Komisioni për banim social	2016 – 2020	Numri i banesave sociale të ofruara Nr i viktimave të strehuara	Gjithësej 21,000.00	Qeveria 21,000.00	
4.1.8. Trajnime për zyrtarët e punësimit, shëndetësisë, arsimit, shërbimeve sociale dhe të tjera për një qasje sensitive gjinore	Profesionistët	IKAP, MPMS ABGJ	Komuna, MASHT, MSH, MPMS-DPP, Donatorët	2016 – 2020	Kalendari i miratuar për trajnimet vjetore të planifikuara Nr profesionistëve certifikuar sipas fushave	Gjithësej 40,353.30		Donatorët 40,353.30
4.1.9. Ngritja e qendrave të	Viktimat	MSH	OJQ, MPMS Donatorët, komunat	2016 – 2020	Nr i qendrave të ngritura	Gjithësej 277,500.00		Donatorët 277,500.00

këshillimit për viktimat								
Objektivi specifik 4.2. Ndarja e fondeve për shërbimet riintegruese afatgjata për viktimat e dhunës në familje, në nivelin qeveritar								
4.2.1. Fuqizimi ekonomik i viktimave me anë të subvencionimit nga ministritë e linjës, (psh për viktimat e dhunës të cilat dëshirojnë të iniciojnë biznese të vogla, apo lirimi nga pagesat për ndjekjen e arsimit, etj)	Viktimat, familjet	Ministritë Komunat	Ministria e Financave, MD, MPMS, MSH, MASHT, Prokuroria e Shtetit-MV-të	2016 – 2020	Nr i viktimave të mbështetura me subvencion, specifikuar sipas llojit të mbështetjes (psh për ngritjen e biznesit të vogël, etj) Nr i rasteve të liruara nga MASHT të pagesës për viktimat e DHF për të hyrë në provime, përfunduar shkollimin në Arsimin dhe Aftësimin profesional (përfshirë edhe testin e maturës, pas dokumentacionit të dorëzuar nga viktimat	Gjithësej 250,000.00		Qeveria 75,000.00 Donatorët 175,000.00

4.2.2. Futja e programeve të veçanta për viktimat e DHF, si nënkategori e vijës kryesore buxhetore të secilës Ministri/institucion	Institucione t qeveritare	MF dhe Ministrinë mbështetëse	MD, MPMS, MSH, MASHT, Prokuroria e Shtetit-MV-të	2016 – 2020	Nr i programeve të mbështetura për riintegrimin e viktimave të DHF % e buxhetit të përdorur për këtë qëllim	Gjithësej 5,749.53	Qeveria 5,749.53	Qeveria Donatorët
Objektivi strategjik 4.3. Përdorimi i politikave të integruara për përmirësimin e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje								
4.3.1. Shfrytëzimi për banim nga viktimat e DHF i objekteve të cilat janë në pronësi nga komunat duke përfshirë viktimat e DHF si kategori përfituese në kriteret për banim social	Viktimat e DHF	Komunat, MPMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komuna, QPS-të	2017 – 2020	Nr i banesave të përdorura për këtë qëllim Nr i viktimave të strehuara	Gjithësej 45,000.00	Qeveria 45,000.00	
4.3.2 Shfrytëzimi për strehimore i objekteve që janë në pronësi të komunave ose nga Qeveria qendrore në përputhje me nenin 284 (4) të Kodit të Procedurës Penale	Viktimat e DHF Strehimoret	Komunat, Ministria e Drejtësisë Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar të Konfiskuar, Prokuroria e Shtetit	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komuna, QPS-të	2017 - 2020	Nr i banesave të përdorura për këtë qëllim Nr i viktimave të strehuara	Gjithësej 99,000.00	Qeveria 99,000.00	

për asetet e konfiskuara përfshirë objektet që mund të ipen për shfrytëzim, si për banim social ashtu edhe për strehimore.								
4.3.3. Hartimi i një Udhëzimi Administrativ apo Vendimi të Kryeministrit për subvencionimin e bizneseve për viktimat e DHF	Viktimat, fëmijët	MD, ABGJ	Ministria e Bujqësisë, Ministrinë mbështetëse, Komuna, bizneset	2016 – 2020	Nr i bizneseve të subvencionuara	Gjithësej 2,714.00	Qeveria 2,714.00	
4.3.4. Përkrahja e strehimoreve me buxhet të vjetor edhe nga ana e komunave	Strehimoret	Komunat	MPMS, OJQ, Donatorët	2016 – 2020	% e buxhetit vjetor që ndan komuna për strehimoren	Gjithësej 748,800.00	Qeveria 374,400.00	Donatorët 374,400.00

4.3.5. Përfshirja në programet ekzistuese dhe hartimi i programeve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje, në bashkëpunim me bizneset private dhe donatorët.	Viktimat e DHF	Komunat, Minis tritë e linjës	MF, QPS, Bizneset, OJQ Donatorët, MF	2016 – 2020	<p>Nr i programeve të hartuara</p> <p>Nr i bizneseve që mbështesin këto programe</p> <p>Nr i viktimave që përfitojnë nga këto programe çdo vit</p>	Gjithësej 284,228.07		<p>Qeveria 143,528.07</p> <p>Donatorët 140,700.00</p>
4.3.6. Ofrimi i lehtësirave (Pako Fiskale) për bizneset që punësojnë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë përfshirë edhe viktimat e dhunës në familje	Viktimat	Qendrat Rajonale për punësim- MPMS, MTI, MZHE dhe komunat	Oda Ekonomike Bizneset, Donatorët	2016 – 2020	<p>Masat e parashikuara për nxitjen e bizneseve</p> <p>Nr i viktimave të punësuar në vit</p>	Gjithësej 12,441.07	Qeveria 11,020.07	Donatorët 1,421.00
4.3.7 Prioritarizimi i punësimit të viktimave/të mbijetuarave të DHF nga Qendrat e punësimit në nivel lokal.	Viktimat QP	Qendrat Rajonale per punesim- MPMS, , MTI. MZHE dhe Komunat	Asociacioni i Bizneseve, Qendrat e Aftësimit Profesional	2016 – 2020	<p>Nr i viktimave të aftësuar në QAP</p> <p>Nr i viktimave të punësuar përmes ZP</p>	Gjithësej 22,150.60	Qeveria 22,150.60	

Objektivi specifik 4.4. Themelimi i institucioneve rehabilituese dhe këshillimoreve me programe të obligueshme për kryesit e dhunës në familje.

4.4.1. Hapja e programeve rehabilituese dhe krijimi i infrastrukturës adekuate për të punuar me kryesit e dhunës në familje, të obligueshme për t'u ndjekur nga ana e tyre në përputhje me Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje	Kryesit	MD/Shërbimi Sprovues	Komuna, MPMS, Qendrat Rehabilituese , MSH, Donatorët	2017 – 2020	Vendimi për hapjen e programeve Numri i programeve të ngritura Nr i kryesve që përfshihen në programet e rehabilitimit	Gjithësej 207,080.45		Donatorët 207,080.45
4.4.2. Trajnimi i personelit të programeve rehabilituese	Mjekët, Profesionistët	MSH / Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik	Departamenti për Punë Sociale, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komuna, Drejtorati i Arsimit në komunë	2016 - 2020	Nr i profesionistëve të trajnuar/certifikuar	Gjithësej 18,569.46		Donatorët 18,569.46
4.4.3 Angazhimi i shërbimit sprovues për ndjekjen e rehabilitimit dhe	Kryesit	MD/Shërbimi Sprovues	MPMS,QPS, OJQ	2016 - 2020	Nr i kryesve të rehabilituar	Gjithësej 200,968.34	Qeveria 197,103.34	Donatorët 3,865.00

riintegrimit të kryesve								
----------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--

